

Rumeli

RUMELİ İSLÂM ARAŞTIRMALARI DERGİSİ

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية | Rumeli Journal of Islamic Studies

eISSN: 3023 - 8498 • Yıl/Year: 2024 • Sonbahar/Autumn • Sayı/Issue: 14



TRAKYA
ÜNİVERSİTELER BİRLİĞİ
İLAHİYAT FAKÜLTELERİ

RUMELİ

İslâm Arařtırmaları Dergisi

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية / Journal of Islamic Studies

Yıl / Year: 2024 – Sonbahar / Autumn – Sayı / Issue: 14



ISSN: 2564-7903
eISSN: 3023-8498

Dergimizin Tarandıđı Veritabanı ve İndeksler:



RUMELİ İslâm Arařtırmaları Dergisi | Journal of Islamic Studies

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية

ISSN: 2564-7903

eISSN: 3023-8498

Kapsam | Scope: Dinî Arařtırmalar, İslam Arařtırmaları, Balkan Arařtırmaları / Religious Studies, Islamic Studies, Balkan Studies

Periyot | Period: Yılda 2 Sayı (30 Nisan & 31 Ekim) / Biannual (30 April & 31 October)

Yayın Dili | Language Publication: Türkçe & İngilizce & Arapça & Arnavutça & Boşnakça / Turkish & English & Arabic & Albanian & Bosnian

Rumeli İslâm Arařtırmaları Dergisi Uluslararası bilimsel hakemli bir dergidir.
Rumeli Journal of Islamic Studies is a international peer-reviewed academic journal.

Yayıncı / Publisher

Trakya Üniversitesi Matbaası
Edirne Teknik Bilimler MYO Sarayıçi Yerleşkesi Edirne, TÜRKİYE

Amblem ve Kapak Tasarımı | Emblem and Cover Design

Dr. Ömer Kasım Kahya

Grafik Tasarım ve Mizanpaj | Graphic Design and Layout

Arş. Gör. Muhammet Küçükbaltaçoğlu

Rumeli İslâm Arařtırmaları Dergisi, Creative Commons Atıf 4.0 International License (CC BY NC) ile lisanslanmıştır. Yazarlar dergide yayınlanan çalışmalarının telif hakkına sahiptirler ve çalışmalarını CC BY-NC 4.0 lisansı altında yayımlanmaktadır.

Rumeli Journal of Islamic Studies is licensed under a Creative Commons Attribution 4.0 International License (CC BY NC). Authors publishing with the journal retain the copyright to their work licensed under the CC BY-NC 4.0.

Rumeli İslâm Arařtırmaları Dergisi'nde yayımlanan yazıların tüm içerik sorumluluğu yazarlarına aittir.

All the responsibility for the content of the papers published in Rumeli Journal of Islamic Studies belongs to the authors.

İletişim | Communication

Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Balkan Yerleşkesi 22030 Edirne- TÜRKİYE

Tel: 0 284 235 68 99 Fax: 0 284 235 08 87

rumelislam@trakya.edu.tr

<https://dergipark.org.tr/rumeli>

<https://rumeli.trakya.edu.tr/>

RUMELİ
İslâm Arařtırmaları Dergisi
Journal of Islamic Studies
مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية

ISSN: 2564-7903

eISSN: 3023-8498

SAHİBİ | OWNER

Trakya Üniversiteler Birlięi İlahiyat Fakülteleri Adına

Prof. Dr. Ali Öztürk

Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

EDİTÖR | EDITOR IN CHIEF

Dr. Mustafa Barış

mustafabaris@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

YARDIMCI EDİTÖRLER | CO-EDITORS

Dr. Halil İbrahim Kaygısız

hibrahimkaygisiz@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

Dr. Zehra Gözütok Tamdoğan

ztamdogan@nku.edu.tr / Namık Kemal Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

Dr. Sıddık Ağçoban

s.agcoban@klu.edu.tr / Kırklareli Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

YAZI İŞLERİ MÜDÜRÜ | RESPONSIBLE MANAGER

Dr. Nurullah Koltas

nurullahkoltas@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

REDAKSİYON / REDACTION

Dr. Uęur Boran

ugurboran@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi



Basım Tarihi / Printing Date

Ekim / October - 2024



<https://rumeli.trakya.edu.tr/> <https://dergipark.org.tr/rumeli>



rumelislam@trakya.edu.tr [rumeliislam@rumeliislam](https://twitter.com/rumeliislam)

Araştırma Makaleleri / Articles

URDHËRIMET PËR MİRËSI DHE NDALËMET NGA E KEQJA NË DISKURSIN FETAR

Geliş Tarihi: 23 Nisan 2024

Kabul Tarihi: 2 Eylül 2024

Rexhep SUMA*

Abstrakt

Parimi fetar “urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja” është faktor qenësor në fushën e thirrjes islame. Në një shoqëri ballkanike ku jetojmë ne si shqiptarë në një shoqëri multikulturore, ku respektohet privatësia dhe ligjet laike i ndajnë çështjet fetare nga ato shtetërore, dhe kjo mbetet një sfidë bashkëkohore për komunitetin mysliman dhe ofron mundësi se si mundet të jetësohet ky parim fetar aq sa mundet dhe i krijohet hapësirë. Ky artikull analizon në mënyrë shkencore themelet teologjike dhe praktike të parimeve bazë të kësaj fushe nga mësimet kuranore dhe profetike. Po ashtu shfaq edhe mundon të kuptoj raportin mes predikuesve (të fesë) me ndryshimet sociale në shoqëritë postmoderne. Gjithashtu ky punim sqaron format e kontrollit social, të ushtruara nga grupet fetare, përfshirë sanksione joformale ndaj kundërvajtësve, si izolimi, turpërimi dhe shmangia. Duke pasqyruar shembuj konkret, si kryerja e riteve fetare, humaniteti, respekti ndaj prindërve, ndershmëria dhe largimi nga gjërat e dëmshme si: vjedhja, droga, alkooli, punimi ilustron se si këto parime ndihmojnë në ngritjen dhe konsolidimin e një shoqërie të drejtë dhe morale. Po ashtu theks i veçantë i kushtohet edhe rolit të këtyre parimeve në përmirësimin e vetëdijes shpirtërore dhe sociale të individëve, si dhe ndikimi i tyre në promovimin e drejtësisë dhe paqes në komunitetet tona. Në këtë punim shkencor është përdorur metoda e analizës teorike, analiza e përmbajtjes, metoda e krahasimit, metoda e deskriptimit. Analiza cilësore mbështetet kryesisht mbi vlerësimin e përmbajtjeve të ndryshme mediatike përmes vëzhgimit, si edhe në një numër të gjerë studiuesish që kanë trajtuar këtë temë nga autorë vendas dhe të huaj.

Fjalë kyçe: Islami, besimi, thirrja islame, urdhërimi për të mirë, ndalimi nga e keqja.

ORDERING FOR GOOD AND PROHIBITING FROM EVIL IN CONTEMPORARY RELIGIOUS DISCOURSE

Abstract

The principle of enjoining good and forbidding evil is a fundamental factor in the field of Islamic calling. In the Balkan society where we live as Albanians, within a multicultural society that respects privacy and operates under secular laws where religion is separated from the state, this remains a contemporary challenge for the Muslim community, offering opportunities for how this religious principle can be lived and created space for. This article scientifically analyzes the theological foundations and practical principles of this field based on Quranic teachings and prophetic traditions. It also seeks to understand the relationship between religious preachers and social changes in postmodern societies. The article clarifies social control mechanisms exercised by religious groups, including informal sanctions against dissenters such as isolation, shame, and avoidance. Through concrete examples like the practice of religious rituals, humanity, respect for parents, integrity, and avoidance of harmful practices like theft, drugs, and alcohol, it illustrates how these principles contribute to the development and consolidation of a just and moral society. Furthermore, significant emphasis is placed on the role of these principles in enhancing spiritual and social awareness among individuals, as well as their influence in promoting justice and peace within our communities. This scholarly work employs theoretical analysis, content analysis, comparative methods, and

* Prof. Asist. Dr. Rexhep Suma, Kosova Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi, Temel İslam Bilimleri Bölümü, rexhepsuma05@gmail.com

ORCID ID: 0009-0009-4920-2838

DOI: [10.53336/rumeli.1472682](https://doi.org/10.53336/rumeli.1472682).

İntihal: Bu makale “iThenticate” intihal tarama programında taranmış ve intihal içermediği tespit edilmiştir.

Plagiarism: This article has been scanned by iThenticate. No plagiarism detected.

Atf / Citation: Suma, Rexhep. “Urdhërimet Për Mirësi Dhe Ndalimet Nga E Keqja Në Diskursin Fetar”. *Rumeli İslam Araştırmaları Dergisi* 1 (2024), 21-35. <https://doi.org/10.53336/rumeli.1472682>.

Copyright © CC BY-NC 4.0

descriptive methods. Qualitative analysis primarily relies on evaluating various media contents through observation, along with a wide range of studies by local and foreign authors who have addressed this topic.

Keywords: Islam, Faith, Islamic Invitation, Ordering for Good, Prohibiting from Evil.

GÜNÜMÜZ DİNİ SÖYLEMDE İYİLİĞİ EMRETME VE KÖTÜLÜĞÜ YASAKLAMA

Özet

Bu makale, laik yasaların hüküm sürdüğü ve din ile devlet işlerinin ayrı tutulduğu Balkan toplumlarında İslamî söylem bağlamında “iyiliği emretme ve kötülükten sakındırma” ilkesini incelemektedir. Makale aynı zamanda bu ilkenin teolojik ve pratik temellerini, Kur’an ve peygamberî öğretilerden nasıl çıkartıldığını anlatmaktadır. Ayrıca bu çalışma, dini tebliğ edenlerin, post modern toplumlarda sosyal değişimler arasındaki dinamiği inceleyerek dini ilkelerin sosyal kontrol ve bireysel davranış üzerindeki etkilerini de analiz etmektedir.

Makale insanlık, dürüstlük ve ebeveynlere saygı gibi dinî değerlerin ahlakî bir toplum inşa etmedeki önemini vurgularken, hırsızlık, uyuşturucu kullanımı ve alkol tüketimi gibi eylemlerin olumsuz etkilerine de dikkat çekmektedir. Tartışma, bu ilkelerin adalet ve barışı teşvik etmedeki rolünü, özellikle Arnavutluk ve Kosova gibi çok kültürlü ve laik toplumlar bazında incelemektedir.

Makale, özellikle seküler hukukun hâkim olduğu ortamlarda “iyiliği emretme ve kötülükten sakındırma” ilkesini uygulamada karşılaşılan zorluklara da değinmektedir. Dinî söylemde bilgelik, sabır ve esnekliğin gerekliliğini vurgularken, farklı dinleyicilere -Müslümanlar, Müslüman olmayanlar ve günahkârlar- uygun bir şekilde hitap etmenin önemini ele almaktadır. Sosyal medyada sıklıkla görülen yüzeysel dinî pratiklerin eleştirisini yaparak, samimi dinî ifadenin gerekliliğini de vurgulamaktadır.

Bunun yanı sıra, makale dinin sosyal değişim üzerindeki daha geniş etkisini ele almakta; bazı dinî unsurların değişimi engelleyebileceğini, bazılarının ise devrim niteliğinde bir itici güç sağladığını belirtmektedir. Arnavutlar arasında tarihsel olarak var olan dinî çeşitlilik konusunda hoşgörüyü ve dinî söylemde nezaket ve saygı ifadelerini kullanmanın önemini de vurgulayarak İslamî öğretilere karşı çıkan ya da yanlış anlayanlarla konuşurken bile saygılı ve hoş görülü davranmanın gerekli olduğunu ifade etmektedir.

Sonuç olarak, makale dinî vaazlarda bilgi, ahlak ve nezaketin önemini vurgulamakta ve bu niteliklerin dinî değerleri etkili bir şekilde iletmek ve toplumu reforme etmek için vazgeçilmez olduğunu savunmaktadır. Vaizlerin hem dinî öğretileri hem de çağdaş toplumsal bağamları derinlemesine anlamalarının ve bilgelik, hassasiyet ve bireylerin toplumun genel refahına odaklanarak iletişim kurmalarının gerekliliğinden bahsetmektedir.

Anahtar kelimeler: İslam Dini, İman, İslamî Davet, İyiliği Emretmek ve Kötülükten Sakındırmak.

Hyrje

Duke u mbështetur në mendimet e dijetarëve të mendimit islam të cilët kanë ofruar disa udhëzime për të rregulluar parimin e urdhërimit për të mirë dhe ndalimi nga e keqja në shoqërinë islame, duke vë në brendi parimin e papranueshme të mohimit në çështjet divergjente (*ihtilaf*), ky nocion vazhdon të jetë edhe më i paqartë në disa raste dhe mund të krijojë boshllëqe logjike për ata që merren me studime të fushës së fikhut apo thirrjes islame. Andaj me të drejtë mund të pyesim se ku radhitet çështja e këtij parimi në mësimet dhe kulturën islame tradicionale. Nisur nga aktualiteti që ndodhemi në si shoqëri islame ku ligji civil (laik) mbetet faktori që determinon rolin e secilit person në urdhërimit për të mirë dhe ndalimin e së keqes. Diskursi hyjnor i drejtohet njeriut dhe ka të bëjë me të vërtetën e tij njerëzore, këtij njeriu do t’i ngarkohet misioni (*risâla*) që do t’i mundëson ndërtimin e familjes së shtrirë njerëzore.¹

¹ Taha Xhabir Ulvani, *Min adab al-ihtilaf ila nabd al-ihtilaf* (muhtasar), The international Institute of Islamic Thought (IIIT), Herndon, USA, p.18.

Shkollarët e islamit kanë qenë të interesuar në sqarimin e parametrave, kontrolleve dhe mirësjelljes së urdhrit hyjnor për në mirësi dhe mënjanimin e të këqijave nën prizmin hulumtues dhe thellimit analizues tërësor ndaj provave të cekura në Kur'an dhe Sunet. Një nga gjërat më të çuditshme që shohim sot është se mjetet e dukshme të thirrjes islame janë zyrat bashkëpunuese, por nuk gjejmë të njëjtin interes dhe mbështetje për to siç bëjmë për të tjerët. Është sikur të turpërohemi ose të kemi frikë të tregojmë thirrjen për fenë tonë të vërtetë, që është qëllimi më i madh në çështjen e *hisbes*. Nga ana tjetër, gjejmë se *hisbe* është e kufizuar në çështje të caktuara, pa ulur rëndësinë e tyre. Por një shpërqendrim i tillë dhe mos dhënia përparësi çështjeve ka dobësuar efektin e këtij mesazhi. Çështjet e mirësisë janë ato që janë të rrënjësura në natyrën e njeriut dhe gjithmonë i gjejmë ato të parat; sepse Allahu dëshiron për ne të mirën. "Pra, urdhëri është gjithmonë më i rëndësishëm se lënia e të ndaluarave; sepse urdhri nënkupton të bërit dhe ndalimi nënkupton të mos bërit. Për këtë arsye, Kurani gjithmonë e vendos urdhrin përpara ndalimit në çdo rast që i bashkon të dyja². Sikurse kemi ajetin kuranor në suren Ali Imran, 110. Ata që përvetësojnë këtë interpretim, preferojnë ta mohojnë kur shohin ndonjë gjë në sunet që nuk përshtatet me zakonet dhe botëkuptimet e sotme. Ky interpretim e krahason çdo gjë që ishte 1400 vjet më parë me konceptet, kuptimet dhe zakonet e shek. XXI. Ky botëkuptim, që sot është i përhapur, beson se kjo është e vërteta absolute.³ Kjo kërkon kohë të riorientojmë jetën tonë sipas rregullores së tillë, ngase së pari duhet të kuptohet qëllimi i kësaj rregulloreje, pastaj të pranohet ajo, para se të zbatohet. Pra, ekzistojnë faza të shumfishta të pranimit të Islamit; nisur nga faza fillestare e njohjes dhe nënshtrimit të personit ndaj Krijuesit, deri te përkthimi i këtij besimi në jetën e tij të përditshme.⁴ Këshillimi për në mirësi dhe ndalimi nga e keqja mbetet reformë, detyrë si dhe edukim duke u mbështetur mbi disa shenja sipas një mesazhi cili kërkon njohuri, njohje e studim që kërkohen veçanërisht nga predikuesi (thirrësi) që të zotërojë aftësi, mençuri, fleksibilitet e durim. Shumicën e kohës urdhërimi në të mira dhe pengimi prej të këqijave bëhet me fjalë. Ky obligim përmbushet më këshillim dhe urtësi nga thirrësit duke prezantuar vlerat fetare të jomuslimanët për të përqaftuar Islamin por edhe nuk duhet anashkaluar edhe kategoria e gjynahqarëve që të kenë një jetë sa më të baraspeshuar nën hijen e ligjeve të Krijuesit.

Në fakt, çështja e fesë ka marrë përmasa edhe në Kosovë, duke parë trendet që zhvillohen sot në botë, te ne në momentin kur flitet për fenë, personalizohen gjërat, njerëzit jo kompetentë flasin për fenë, pastaj ka një serë paragjykimesh mbi fenë, stereotipe të ndryshëm, duke etiketuar herë njërin e herë tjetrën fe. Praktikimi i fesë është e drejtë njerëzore e garantuar, madje ajo ka të bëjë edhe me identitetin e vet individit dhe se shpërfaqja e identitetit fetar ka një rëndësi të madhe për të. Mirëpo, instrumentalizimi i fesë për shkaqe të ndryshme, jo vetëm që i jep konotacion negativ si spiritualitet, meditim, adhurim, ritual, por mund të çojë edhe deri te përkeqësimi i gjendjes në Kosovë dhe të shkaktojë polarizime në

² Aouidh Mahmoud Al-Otaibi, *El emru bi'l marufi ve'nehji anil' munker fil'kuran*, Riad, 1436, f.33.

³ Mehmet Görmez, *Sünnet ve Hadisi Anlama Kilavuzu*, Otto, Akara, 2020, f.105.

⁴ Ziauddin Sardar, *Fytyra të Islamit*, përktheu Mimoza Sinani dhe Elma Berisha, Logos-A, Shkup, 2017, f.155.

shoqëri. Një gjë e tillë më se miri u pa me rastin e rritjes së radikalizmit fetar dhe pjesëmarrjes së një pjese të qytetarëve në luftërat e Irakut dhe të Sirisë.⁵

Mesazhet fetare tani po shpërndahen me anë të mediave sociale që sigurisht edhe ndikimi tyre është shumë i madh. Përhapja e mesazheve fetare në disa ditë dhe net të rëndësishme nëpër mediat sociale, madje edhe nga ata njerëz që jetojnë një jetë larg jetesës fetare dhe absolutisht laike, dashje pa dashje, e ka bërë të pashmangshme ekzistencën e një feje revistash. Është e mundur që të hasesh me dhjetëra shembuj njerëzish, që kanë hedhur në mediat sociale fotografitë që kanë bërë me shokët duke u argëtuar e duke pirë pije alkoolike, ndërsa ditën e nesërme poston mesazhe urimesh për netët e mira të fesë Islame. Madje po aq e mundur është që të shohësh edhe persona që urojnë ditën e premtë, ndërkohë që jo vetëm nuk kanë shkuar ndonjëherë për të falur namazin e Xhumasë, por as që nuk e dinë fare se si mund të falet namazi.⁶ Tani jemi duke dhënë provimin e fjalës. Me qëllim që të verifikohet se kush do t'i qëndrojë besnik fjalës së dhënë e kush do ta tradhtojë atë. Thelbi që e bën jetën me kuptim, lind nga fjala. Krijuesi esencën tonë e bëri të përshtatshëm për fjalën.⁷

Nga urtësia në thirrjen islame është që tu flasësh njerëzve sipas mentalitetit të tyre, në përputhshmëri me gjendjen, duke krahasuar shkallën e besimit të tyre dhe gjendjen në të cilën gjenden. Nuk është prej urtësisë t'i drejtohet myslimanit në udhëzimin e tij, në nxitjen e tij për të kapur për fenë, ashtu siç i drejtohem i ateistit, politeistit, çifutit, të krishterit apo pa besimtarëve tjerë.⁸ Gjuhë disruptive (përçarëse/ndarëse) e cila jo rrallë herë përfundon në konflikt, sikurse në stilin e komunikimit me masën duhet larguar apo minimizuar përdorimin e gjuhës emocionale. Gjuha është element që ndihmon që ne të arrijmë të shprehim sesi ndihemi dhe si t'i determinojmë marrëdhëniet dhe sjelljet tona me të tjerët - xhematin në diskursin e këshillimit në mirësi si dhe pengimin nga cilësitë e liga. Duhet të zotërohen shkathtësi të larta, pranimi i kulturave të përziera, besimet, traditat dhe zakonet që njerëzit ndajnë dhe mësojnë. Thirrja islame në përfundim ka specifikat e saja ku ka xhemat me kultura të përziera kombe të ndryshme brenda një shoqërie, që detyrimisht edhe ndryshimet ekzistojnë nga se kombet kanë dhe zhvillojnë modele unike të komunikimit. Komunikimi është së pari një fakt kulturor dhe politik, e jo teknik thjesht sepse njeriu gjendet nga kjo anë e pasqyrës së botës që ne e quajmë kuptim dhe veprim. Teknika vlerësohet vetëm si modifikuese e natyrës, ajo është tashmë një problem social, megjithëqë përmasat e saj funksionale.⁹

Përderisa disa aspekte të fesë e pengojnë ndryshimin shoqëror, disa të tjera e sfidojnë status quo-në dhe i japin shtytje ndryshimit. Në disa rrethana feja përbën një formë me taban revolucionar, ofron një vizion

⁵ Ferdi Kamberi, *Dilemat e tranzicionit*, Artini, Prishtinë, 2019, f.313.

⁶ Murat Dağitmaç, *Neuropsikologu Şehadet ekmen, përktheu shqip*, Blerina Coka, Tiranë, 2020, f.87.

⁷ Ramazan Kayan, *Thirrja islame akt profetik*, Prizren, Fleta, 2017, f.53.

⁸ Seid el Kahtani, *El hikmetu fid'daveti ilellahi teala*, Riad, botim i IV, 1424, f.757.

⁹ Eric Maignet, *Sociologjia e komunikimit dhe medieve*, përktheu nga frëngjishtja Blerta Hyska, Papirus, Tiranë, 2010, f.17.

për atë se si duhet apo se si nuk duhet të rregullohen gjërat. Përgjatë historisë feja - për shkak ndikimit të vet të veçantë në bashkimin e bindjeve të besimtarëve me veprimet, në bashkimin e ideve të tyre me jetën shoqërore - ka qenë një ndër motivuesit më të rëndësishëm të ndryshimit.¹⁰ Shqiptarët kanë ditur të jenë tolerantë në aspektin e fesë dhe kanë bashkëjetuar pa luftëra fetare mes tyre.¹¹ Në komunikimin me masën thirrësi për pengimin e të këqijave ashtu si shprehja e fytyrës, gjestet dhe qëndrimet e trupit janë përdorur vazhdimisht për të plotësuar shqiptimin e fjalëve, si edhe për të përçuar kuptime atëherë kur në fakt nuk thuhet gjë.¹² Kur jemi te parimi i thirrjes me të mirë në urdhëresat e krijuesit është i qartë stili i butë dhe i matur të cilin Allahu xh.sh., kërkon që Musai a.s., të thirrte një njeri arrogant dhe tiran, pra thirrja e Musait drejtuar Faraonit nuk duhet të jetë një akti i kryer, por një trajtë, në të cilën do të tregohet respekt i madh për vullnetin e tij dhe do të mbrohet krenaria e tij.¹³

Ekzistojnë dy tipa traditash: tipi i parë bazohet mbi shpikësin e traditës, ku pranuesi i shpalljes është ai në të cilin është mishëruar ajo dhe vetë ai është Fjala e Allahut dhe mesazhi hyjnor. Në këto tradita nuk ekziston gjuhë e shenjtë, sepse trupi apo forma e jashtme e mishëruesit (traditës) është forma e dukshme e fjalës së Allahut, prandaj në krishterizëm Mesihu vetë është Fjala e Allahut.¹⁴ Kurani parashtron një parim unik në lidhje me trajtimin e jomuslimanëve. Ai i jep autonomi të plotë çdo bashkësie fetare që gëzon jo vetëm lirinë e besimit dhe të adhurimit në mënyrën e vet, por është e lirë t'i ndjekë ligjet e veta dhe t'i vendosë çështjet përmes gjykatësve të vet.¹⁵

Qetësia dhe urtësia janë esenciale në parimin e urdhërimit për të mirë dhe ndalimi prej së keqes. Kurrë nuk duhet bërë vlerësimi i njerëzve, edhe nëse sheh dikë duke bërë gjynah, mos u bëj prej atyre që bien në fjalët e masës. Ne gjykojmë sipas të dukshmes, e Allahu i di të fshehtat, kurse ne nuk jemi të obliguar t'i gërmojmë thellësitë e brendshme të njerëzve e as të hulumtojmë.¹⁶ Përveç kësaj, dallimi në të menduarit dhe kuptuarit shihet edhe në përcaktimet dhe drejtimet e ndryshme. Të gjitha këto e detyrojnë thirrësin që gjatë thirrjes të kenë kujdes për hyrjen e cila duhet të përputhet me karakterin dhe të jetë prekëse për ta.¹⁷ Nëse themi që thirrja me urtësi komunikon me logjikën e njeriut dhe e bind atë, pa dyshim që thirrja me këshilla të mira e të mbara komunikon me vete zemrën e ndjenjat duke ndikuar në to dhe duke i gjallëruar. Njeriu nuk ishte vetëm me mendje, por me mendje dhe zemër njëkohësisht. Ai

¹⁰ Meredith B. McGure, *Religjioni konketksti shoqëror*, përktheu nga anglishtja Ali Pajaziti, Logos.A, Shkup, 2007, f.377.

¹¹ Artan Fuga, *Komunikimi në shoqërinë masive*, Papirus, Tiranë, 2014, f.340.

¹² Anthony Giddens, *Sociologjia*, përktheu Teuta Starova Kastriot Myftiu, Çabej, Tiranë, 2004, f.100.

¹³ Hayati Aydin, *Kur'anda psikologjik Ikna*, Timas Yayinlan, Istanbul, 2001, f.27.

¹⁴ Sejjid Husejn Nasr, *El- Kur'an u kelimetull-llahi, masdaru el- ma'rifeti ve el-fi'ili*, i arabizuar nga Musa Safvan, revista "El-Mehaxhheh", daru el- Hadi,nr.10, Bejrut, 2004, f.18.

¹⁵ Muhammed Hamidullah, *The emergence of islam- Lectures on the development of islamic world-view, intelectual tradition and polity*, Islamic Research Institute, 3rd reprint, Islamabad, 1999, p.340.

¹⁶ Muhamed Ratib Nabulsi, Tefsiru en-Nabulsi: tedebberu ajati'l lahi fi en-nefsi ve el-keveni ve el-hajati, vëll i katërt, Kaptina el -En'amë Kaptina el-Ea'raf, El Fursan, botimi parë, Amman, 2017, f.295.

¹⁷ Fet'hi Jekin, *Kejfe ned'u ile'l islam*, Muesetu errisale, Bejrut, botim i III-të, 1977. f.21.

ka mendjen me të cilën kupton e mendon e po kështu edhe zemrën me të cilën ndjen, andaj na duhet të komunikojmë me të dy këto aspekte në të njëjtën kohë, si me anën që ka të bëjë me të kuptuarit (mendjen) ashtu dhe me atë që ka të bëjë me ndjenjat (zemrën). S'do mend se të gjithë njerëzit ndonjëherë kanë nevojë t'u flasësh me urtësi e ndonjëherë me këshillë (butësi e mirësi), edhe pse ajo pjesa e quajtur e veçantë ndihet më shumë e nevojshme për komunikim me urtësi që më pas të gjykojnë me njohuritë e tyre dhe mendjen që posedon. Ndërsa masat e gjëra janë më të ndjeshme ndaj komunikimit me këshilla (butësi, mirësi), pasi kjo prek ndjenjat e tyre dhe shtyn dëshirat që kanë drejt së mirës. Kur'ani nuk e ka cilësuar urtësinë me ndonjë gjë të veçantë pasi kujt i është dhënë urtësi i janë dhënë shumë të mira (ose e mira e madhe), siç edhe thotë ajeti 269 i sures el Bekare.¹⁸ Detyra e dhënies së këshillës së mirë ndjek atë të kumtimit të mesazhit (et-teblig), ngaqë këshilla e dhënë bazohet në mesazhin e bërë të njohur. Që nëse personi i këshilluar e ndjek atë, do t'i sjellë dobi atij apo asaj.¹⁹

Sipas teoricientëve të komunikimit dhe predikimit ekzistojnë disa tipare me të cilat një predikues duhet të pajiset në rrugën e misionit të tij sa i përketë urdhërimeve për në të mirë dhe ndalimin e të këqijave për të reformuar shoqërinë dhe ambientin social ku ai zhvillon predikimin dhe komunikimit e fesë

1. Të zotërojë njohuri të bollshme mbi kulturën dhe dispozitat fetare, si dhe të ketë aftësi të mjaftueshme në atë dituri për shpjegimin e saktë dhe të drejtë të fesë.

قُلْ هَلْ يَسْتَوِي الَّذِينَ يَعْلَمُونَ وَالَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ أُولُو الْأَلْبَابِ

*Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.*²⁰

Kurse edhe mësimet peygamberike na sinjalizojnë se Allahu xh.sh. e çmon përpjekjen në punë të mirë nga robërit e Tij. Sahabiu i nderuar Ebu Hurejre na transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: "*Allahu, ka urdhëruar: Nëse robi im niset me qëllimin që të kryej vepër të mirë dhe nuk mundet ta bëjë dot, atij i shkruaj një sevap (të mirë). Nëse (robi im) niset me qëllimin për të kryer vepër të keqe, dhe nuk e vepron atë, nuk e shkruaj shkruaj (si gjynah), por në qoftë se e vepron, i shkruaj vetëm një të keqe (mëkat).*"²¹

2. Devotshmëria

Ky tipar i bukur kuranor me anë të së cilit mbrohet figura e predikuesit të rrëshqet drejt elementeve të dyshimta, së këtejmi këshillën të cilët e ofron, gjenë zbatueshmëri dhe akceptim në gjirin e tyre. Kjo argumentohet edhe me hadithin profetik se njeriu nuk do të arrin shkallën e takvallëkut, derisa të distancohet plotësisht nga e dëmshmja dhe çdo gjë ndërlidhet me të. Devotshmëria reflekton dritë ndarëse mes të keqes dhe të mirës dhe kjo i ofron predikuesit të demonstrojë dhe reflektojë shëmbëlltyrë

¹⁸ Jusuf Kardavi, *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*, përktheu Flori Kola, Furkan ISM, Shkup, 2018, f.51.

¹⁹ Taha Xhabir el-Alvani, *Reviving the balance. The authority of the Qur'an and the Status of the Sunnah*, shqipëroi Bujar H. Hoxha, Logos-A, Shkup, 2022, f.39.

²⁰ <https://tanzil.net/#trans/sq.ahmeti/39:9> (data e qasjes më 12.04.2024).

²¹ *Muslimi*, 3335, Iman, 204; Buhari, 6491, Rikak, 31.

e praktikimit të vlerave të mirëfillta fetare. Gjatë procesit të thirrjes islame, hasim edhe kategorinë e mëkatarëve të cilët bëjnë gjynahe haptazi, dhe ne duhet të kemi kujdes me këtë shtresë njerëzish, që mos ta urrejmë askë për personin por veprën e tij të bërë. Kjo më së miri nënkuptohet nga ngjarja e cila ka ndodhur gjatë kohës së Muhamedit a.s., kur një grup sahabësh sollën një individë për t'ia shqiptuar masën ndëshkuese për shkak se kishte konsumuar alkool. Sigurisht që i Dërguari a.s. zbatoi urdhrin mbi këtë vepër duke e ndëshkuar ate, kur sahabët e godisnin mëkatarin derisa një nga sahabët ofendoi të dehurin me fjalë të rënda. Atëherë i Dërguari a.s. posa e dëgjoi, ndërhyri dhe tha: "Jo, mos thoni ashtu! Mos e ndihmoni shejtanin kundër tij!"²² Edhe nëse dikush ka mëkatuar, meriton ndëshkimin porse nga ne kërkohet që ta ruajmë nderin dhe moralin e tij.²³

3. Morali

Mirësjellja është elementi kyç në fushën e predikimit të urdhërimit në mirësi dhe pengimit nga devijimet shoqërore në misionin e komunikimit të thirrjes islame. Mungesa mirësjelljes rezulton në devotshmëri të cunuar dhe si rrjedhojë as dituria nuk do t'i hynte në punë. Ndër cilësitë që duhet t'i ketë predikuesi është ushtrimi i kontrollit mbi vetveten në çfarëdo situatë me të cilën ai përballet, qofshin ato fytyrë, cenim të figurës së tij, kërcënime në pasuri, reputacion, apo presione tjera psikologjike e sociale të cilat ato e bëjnë të shmang vëmendjen dhe objektivin e tij të cilin ai dëshiron ta përmbush. Islami i ka vendosur moralin e larta në thelb të mësimave të tij fetare. Këto morale përfshihen nga urdhëresat dhe ndalesat kuranore e profetike. Vlerat morale përfshihen në urdhrat e Allahut të Madhëruar dhe konsiderohen detyra madhore, ndërsa ndalesat përfshihen në ato gjera, të cilat Allahuxh.sh., i ka ndaluar dhe i ka bërë haram. Disa nga këto vlera madhore janë: drejtësia, bamirësia, sinqeriteti, amaneti, mbajtja e besës, përmbushja e premtimit, mëshira ndaj krijesave, durimi në vështirësi dhe situata të rënda, turpi, thjeshtësia, krenaria me besimin, trimëria, bujaria, ndershmëria morale, butësia, falja kur ke mundësi të hakmerresh, përmbajtja e zemërimit, bamirësia ndaj prindërve, mbështetja financiare e të afërmeve, bamirësia ndaj fqinjëve, dhembshuria ndaj jetimeve, rrugëtarëve dhe shërbëtorëve, ndihma e te dobët dhe shpëtimi i halleve. Të gjitha këto janë nga urdhëresat më madhështore të fesë, me të cilat Allahu i Madhëruar i nxit besimtarët, duke përgëzuar bamirësit dhe të përkushtuarit.²⁴

Duke studiuar biografinë e Pejgamberit a.s., gjejmë se ai ishte delikat dhe i sjellshëm. Kjo cilësi e tij shihet jo vetëm nga mënyra se si silllej ndaj anëtarëve të familjes, ndaj myslimanëve të tjerë, delegacioneve të ardhura për vizitë në Medinë, personave që thërriste në Islam dhe atyre që u dërgoi letër, por edhe ndaj idhujtarëve. Për shembull, gjatë Umres së vonuar, kur u plotësua afati tregëtar dhe Hz. Pejgamberi po qëndronte në çadrën prej lëkure të ndërtuar në vendin e quajtur Ebtah, bashkë me

²² Buhariu 6777, Hudud, 4, Ebu Davud, 4477, Hudud, 35.

²³ *Islami nëpërmjet haditheve*, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Shkup, Logos-A, 2017, botim i II, v.3, f.122.

²⁴ Jusuf Kardavi, *Islami për tek i cili ftojme*, përktheu nga arabishtja, Rushit Musallari, Furkan ISM, Shkup, 2022, f.45.

Sa'd b. Ubade nga ensarët, pranë tij erdhën Suhejl b. Amri dhe Hu'uejtib b. Abduluzza nga idhujtarët e Kurejshit. Duke i kujtuar se ishin plotësuar tri ditë sipas marrëveshjes, kërkuan që të largohet nga Meka. Në atë kohë, Sa'd b. Ubade u zemërua me Suhejl b. Amrin dhe i tha: " ... Këtu nuk është as toka jote dhe as e babait tënd. Rasulullahu largohet nga këtu veçse me bindjen në zemër dhe duke respektuar marrëveshjen." Pas kësaj, Pejgamberi ynë buzëqeshi. Kthehet ndaj Sa'dit dhe urdhëroi: "Mos i lëndo ata që kanë ardhur për vizitë aty ku po qëndrojmë" dhe u dha urdhër sahabëve që të niseshin.²⁵

4. Të qenurit i butë

Shpeshherë predikuesi ndodhet para disa situatash të pa këndshme në të cilat nëse shfaq butësinë dhe dhembshurinë, impakti i sjelljes së tij do të reflektonte pozitivitet mbi të ftuarin. Kjo njëherit është edhe porosi e Profetit a.s. se ai këshillonte në butësi sepse këtë cilësi e pëlqen edhe Allahu xh.sh. Ky tipar më së miri nënkuptohet edhe nga thënia profetike ku Aishja r.a., transmeton se i Dërguari a.s. thoshte se: "Gjërat zbukurohen me mirësi, ndërsa ashpërsia i shëmton ato"²⁶ Butësia si konditë ka bazën e fuqishme në burimet e sheriatit, pra në Kuran dhe hadith. Në ligjëratën të cilën Allahu xh.sh., i drejtohet Musait a.s. dhe Harunit a.s., thotë:

أَذْهَبَا إِلَى فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَى فَقُولَا لَهُ قَوْلًا لَيِّنًا لَعَلَّهُ يَتَذَكَّرُ أَوْ يَخْشَى

"Që të dy shkoni te Faraoni, ngase njëmend ai e ka tepruar. Flisni atij fjalë të buta, në mënyrë që ia të arrijë të mendoj apo të frikësohet" ²⁷ .

Të shprehurit në mënyrë të qartë e shpjegon të vërtetën, por është e shprehur në mënyrë të butë sa që mohuesi i së vërtetës nuk ka pse të nervozohet. Por edhe nga tradita apo gurra profetike në këtë aspekt kemi nxitje për këtë cilësi. "S'ka mundësi që të ekzistojë butësia në ndonjë vepër përpos që e zbukuron-hijeshon atë dhe s' ka mundësi që t'i merret butësia ndonjë vepre, përveçse do ta shëmtojë atë". "Vërtet Allahu e do butësinë në çdo çështje, ajo që jepet me butësi nuk mund të merret me forcë".

Tefsirologu i njohur, Ibn Kethiri, kur komentoi ajetin 105 të Sures El Maide thoshte se: Zoti iu drejtohet robërve të Vet besimtarë që ta përmirësojnë veten dhe të bëjnë mirë me mundin e fuqinë e tyre që kanë, për të vënë në njohuri mbi faktin se ai i cili e ka rregulluar veten, nuk e dëmton e keqja e njerëzve të prishur, pa marrë parasysh nëse njeriu i tillë është afër apo larg atij. Njerëzit nëse shohin dukuri negative në mjedisin e tyre dhe nuk mundohen ta ndryshojnë, atëherë do, ata le të përgatiten për ndëshkimin e Allahut xh.sh. për shkak kësaj të keqeje." Tha: E kam dëgjuar Ebu Bekrin duke thënë: O njerëz, ruajuni nga gënjeshtria, sepse gënjeshtria, njëmend është antipod i besimit.²⁸ Thirrësi duhet të shfaq mirëpritje

²⁵ Ibrahim Saricam, *Hz. Muhammedi dhe mesazhi i tij universal*, Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, përktheu Florida Kulla, Ankara, 2018, f. 353.

²⁶ Muslimi, 2594.

²⁷ Taha 20/43-44.

²⁸ Imam Hafidh e bil Fida Ismail ibn Kethir el Kureshi Ed-dimeshki, *Tefsiru'l Kur'anil adhim*, Darul' marife, Bejrut, v.1, 1993, f. 645.

ndaj tjetrit. Ai duhet t'i dojë dhe t'i vlerësojë përpjekjet e tyre, të këshillojë njëri -tjetrin dhe të bashkëpunojë ngushtë me masën, sa herë që të jetë e mundur. Sikurse që ai gjithashtu duhet të përfitojë nga çdo përpjekje e një personi ose grupi, pa marrë parasysh sa të paktë mund të jenë numri, madje edhe nëse ka diçka të gabuar ose të mangët në atë grup myslimanësh. Duhet të kërkojmë justifikime për ata që kanë mendime të ndryshme me ne dhe, në këtë prizëm, të marrim për bazë thënien e famshme të Shejh Muhamed Rashid Rida: Bashkëpunojmë në atë çështje që kemi rënë dakord dhe justifikojmë njëri-tjetrin për çfarë nuk pajtohemi.²⁹ Që të ndërtohet sot koncepti mbi të kuptuarin ë drejtë dhe të saktë të islamit është e nevojshme të rishikohet tërësisht realiteti ndryshues që të formojmë -konsultojmë- një argument me të gjitha detajet dhe të ngritën dispozita mbi subjektivin e saj.³⁰ Edhe Pejgamberët ishin dërguar në gjuhën e popullit të vet që të interpretojnë saktë mesazhin hyjnorë. (Shih Suren Ibrahim, 4). Prandaj njohjen e gjuhëve të gjalla apo së paku njëren prej tyre e konsiderohet nevojë për thirrësin në kohën tonë. Shkurtimisht këto janë gjërat themelore në të cilat sot bazohet edukimi bashkëkohor. Shihet qartë se kjo nuk arrihet vetëm prej librave, sepse kjo është kulturë e cila thirrësi mund ta gjejë edhe në gazeta, revista, botime periodike, raporte dhe botime zyrtare dhe jo zyrtare. Thirrësi në islamë është ai që posedon vetëdije të zgjuar dhe ndjenjë të mprehtë, prandaj edhe mund të marrë furnizim të ri prej gjithçkaje që e rrethon, prej ndodhive të përditshme jetësore: vështrimeve, agjencive gazetareske etj. Madje thirrësi mund të vijë deri te informatat drejtpërdrejtë nga burimet e gjalla, nga takimet me njerëz, nga përzierja me ta, vëzhgimi i gjendjeve të tyre, dëgjimi i rrëfimeve të tyre, në rrugë apo në shtëpi, sepse udhëtimi është gjysmë dituri. Për atë ulemaja jonë klasike ka urdhëruar mjaftë në kërkim të diturisë për të rritur deri te ajo, madje edhe deri te shtëpitë e atyre që e posedojnë atë.³¹

5. Funkcionalizimi i të lejuarave për ndryshimin e të këqijave

Në misionin e tij predikuesi fetar i gëzohet çështjes së një të ri kur udhëzohet dhe përqafton Islamin, mirëpo ky gëzim disa herë, tejkalon kufirin e tij dhe ndodh të gabojmë, ndërsa ishte e mundur të mos gabonim. Për hir të interesit tonë dhe interesit të të udhëzuarit të ri dhe që të mos gabojmë, nevojitet mos verbim për njetin e të udhëzuarit të ri, ofrim i butësisë, dhembshurisë, të thellohet në mësimet islame, me nijet, kuptim dhe sjellje.³² Personi duhet që para se tua mësojë të tjerëve të mësojë vetë të marrë mësim dhe të mendohet për përgjegjësitë e tyre. Së pari duhet të jetë një besimtar i mirë e më pas të mendohet që tua zgjidhë të tjerëve problemet.³³ Predikuesi apo që ka marrë parasysh që të

²⁹ Hisham Talib, *Etika e thirrjes islame drejt një fiese të moderuar në Islam*, përktheu Gentjan Fejzullaj, ISHMQI, botim i II-të, Tiranë, 2020, f.69.

³⁰ Abdallah Bayyah, *Tenbihu'l meraxhië ala te'ësili fikhi'l vakië*, botim i 4, Mesar lit'iba ven'neshr, Dubai, 2018, f.206.

³¹ Jusuf Kardavi, *Edukimi kulturor i thirrësit*, përktheu Agim Abazi, Shoqata Bamirëse e Katarit me pëlqim të BIK-ut, Prishtinë, 2002, f.179.

³² Hisham Talib, *Besëlidhja e thirrjes islame*, Shkup, Logos-A, 2017, f.58.

³³ Ramazan Tamer Büyükküpcü, *Ta jetosh jetën sipas Islamit*, përktheu Asllan Shehu, Alsar, Tiranë, pa vit botimi, f.96.

përmirësojë një ves të ligë në shoqëri, duhet të ketë vëmendjen e lartë ndaj dinjitetit të personit njerëzor në kohën mesjetare prodhoi shoqëri në të cilat bashkësitë jomyslimane lulëzuan për shekuj. Bindja ishte se të drejtat e caktuara barteshin më të plota prej atyre që pranonin shpalljen e fundit të Zotit në Kuran.³⁴ Sot objektiv parësor është dhe duhet të jetë brezi i ri i cili shpeshherë bie viktimë e depresionit social si dhe negativitetit të madh sidomos në kohën e digjitalizimit të botës dhe jetës sonë. Predikuesi ofron optimizëm dhe qasje tepër vëllazërore ndaj tyre dhe duhet të ketë parasysh faktin se ato janë krijesa njerëzore, gabojnë dhe mëkatojnë, përkundër natyrës së engjëjve të cilat si krijesa janë të pa gabueshme dhe janë të krijuara nga drita. Në lidhje me këtë Krijuesi i drejtohet të Dërguarit të Tij në ajetin 53 të sures Ez-Zumer, duke i thënë që të mos humbasin assesi shpresën nga mëshira dhe rahmeti i të Gjithmëshirshmit se Ai është falës dhe mëshirues. Aktiviteti i thirrësit për në Islam lehtësohet nga veprimet e tilla sepse gjeneratat e reja do të merrnin formim edhe edukim dhe do të brumoseshin në frikë respektin ndaj Krijuesit Fuqiplotë dhe të gjitha energjitë dhe forcat e veprimtarinë e tyre do t'i drejtonin drejt harmonisë, zhvillimit të moralit në shoqëri, duke ndriçuar errësirën e cila kishte kapluar ata gjatë jetës së tyre të mëhershme. Errësira e pabesimit ose besimit të shtrembër shkatërron shoqëri, popuj dhe qytete, sa do të ngritura dhe të zhvilluara qofshin ato. Gjatë predikimit është normale që frika e aftësija të gjenerojnë të njëjtin reagim, me dy opsione; përballu ose mbathja. Sapo përjetojmë një ndjenjë të tillë, trupin tonë e përshkojnë klimatike që prodhojnë, ose gatishmërinë tonë për t'u ndeshur, ose atë për të ikur sa më larg. Nga pikëpamja sasiore, frika mund të shprehet në lidhje me rritjen e vlerës së adrenalines në gjak.³⁵ Toleranca implikon nga ana morale relativitetin e përgjithësuar të funksioneve/shenjave, të objekteve/shenjave, të qenieve/shenjave, të marrëdhënieve/shenjave, të ideve/shenjave.³⁶ Në fakt, ne jemi përtej kundërshtisë trukim/sinqeritet.³⁷ Nëse është interesi më i madh në zbatimin e tyre duhet urdhëruar që të kryhen, edhe pse në të ka edhe veprim të keq. E nëse është e kundërta ashtu, më i madh është dëmi sesa dobia, duhet urdhëruar që të zbatohen ato, edhe pse do të kalojë ndonjë e mirë pa u vepruar. E kur nuk është në gjendje ta vlerësojë se a ka më shumë dobi sesa dëm ose anasjelltas, atëherë ai do të bëjë një analizë situatës me vëmendje dhe që të mos i japë përparësi asnjërit veprim pos me dije dhe sinqeritet.³⁸

Shqetësimi i predikuesit është vetëm zbrazja e informacionit dhe jo shpjegimi i tij, dhënia e një informacioni sa më të bollshëm, por jo edhe kuptimi i tij. Mënyra e thjeshtë e komunikimit dhe e paraqitjes, fjalët e ëmbla dhe të këndshme, të gjitha këto shtyjnë njerëzit drejt dëgjimit, mësimit, ndikimit dhe praktikës. Mënyra e vështirë e paraqitja e paqartë i shtynë njerëzit të largohen. Dhe është

³⁴ Tim Winter, *Besimi, arsyeja, shpallja pikëtakimet e reja*, përktheu Arjol Guni dhe Rezart Beka, Erasmus, Tiranë, 2013, f.43.

³⁵ Chris Anderson, *Ted Talks*, përktheu nga anglishtja Valbona Nathanaili, Pema, Tiranë, 2016, f.241.

³⁶ Jean Baudrillard, *La société de consommation*, përktheu Altin Qefalia, Logos-A, Shkup, 2020, f.173.

³⁷ Stephen E. Lucas, *The art of public speaking*, Mc Graw-Hill, New York, 2007, f.502.

³⁸ Abdulkerim Zejdani, *Usulu'd-ave*, Muesesetu errisale, Bejrut, botimi i IX-të, 1999, f.579.

më se e qartë se çfarë pasojash lë kjo.³⁹ Po ashtu një tjetër element shumë i rëndësishëm për predikuesit, ai duhet të njoh ambientin ku operon dhe ku ka vendosur të kryej punën e predikimit. Çështjet apo meselet në të cilat dijetarët nuk kanë ujdi, mos t'i vendos, në sferën e urdhërimit e këshillimit për të mirë dhe ndalimit e preventivat nga të këqijat. Si konditë tjetër është e keqja të jetë e dukshme. Po ashtu të jetë e kohës së tashme e jo të kaluarës, prolongimi i këshillimit dhe urdhrit për mirësi dhe pengimit e ndalimit nga të këqijat në kohë të përshtatshme, të shfrytëzohen mundësitë të cilat do ta realizonte këtë efekt. Ndër të tjera numërohen edhe, sinqeriteti, durimi, obligim është komunikimi, të mbulojë dhe mos të skandalozë modestia, t'i përmbahet asaj që urdhëron, mos shoqërimi me njerëz të këqij, të kërkoj këshilla dhe ndihmë nga ata që ka besim.⁴⁰

Jetojmë në një botë ku natyra e komunikimit ka ndryshuar në mënyrë dramatik krahasimisht me dekadat e shkuara. Sot jemi të pajisur me teknologji komunikimi të cilat 20 vite më parë ishin pjesë e fantazisë sonë apo e filmave fantastiko-shkencorë. Pavarësisht mundësive që na jep teknologjia, sfidat e komunikimit sot janë shtuar.⁴¹ Në fokus të aktivitetit thirrësi në islam duhet ta ketë parasysh rregullin e pashkruar se vepra e mire nuk bëhet e ligë dhe e liga nuk bëhet e mirë. Nganjëherë mund të ketë edhe përzjerje apo komplikime gjatë thirrjes islame, të dominoj njëra mbi tjetrën për tu përshtatur në rrethana të kohës dhe kushteve mjedisore e ndoshta edhe interesave parciais, grupore etj. Këtu është me rëndësi të citohen mendime të disa shkollarëve myslimanë të cilët çështjet e urdhërimit për mirësi dhe ndalimit nga të këqijat i definojnë se ai është nocion unifikues për gjithçka që ngërthen nënshtrim dhe afrim të Allahu xh.sh., dashamirësi dhe mirësjellje ndaj të tjerëve dhe largim nga e shëmtuara dhe e dëmshmjja.⁴² Komunikimin me masën ku imami këshillon për mirësi dhe ofron ndalim nga të këqijat do vë në orbitën si dhe zonën e tij të influencës edhe tërheqjen e vërejtjes për lëshimet dhe shmangiet si dhe komentimin e teksteve fetare në formë të palejuar që largojnë nga qëllimet dhe objektivat e teksteve. Tekstet kuranore duhet të përshtaten me kohën dhe realitetin dhe kjo duhet të jetë një përpjekje shtesë e imamit apo predikuesit edhe pse ai është në kundërshtim me islamin, dhe të komentohen tekstet fetare larg asaj që ato udhëzojnë, në mënyrë që realiteti të përfitojë legalitetin shariatik. Këtë e kemi parë në përpjekjet e shumta për të lejuar sistemin kamator në vendet islame ku sundon sistemi kapitalist, si dhe të orvatjet për të arsyetuar uzurpimin dhe konfiskimin e pasurisë private gjatë kohës së sundimit socialist në ato vende.⁴³

³⁹ Adnan Al Aaur, *Menhexh ed-daveti fi devi- l- vakië el muasir*, botim i parë, Riad, pa vit botimi, f.198.

⁴⁰ Muhamed Mustafa Shami, *Davabit ve adab el emru bil ma'rufi ve nehji anil munkar*, <https://www.makkahacademy.org>, 1.09.2022.

⁴¹ Ronald B. Adler, George Rodman, Athena du Pré, *Hyrje në komunikim*, Uetpress, Tiranë, 2023, f.21.

⁴² Muhamed Essefarini, *Gidhau-l-bab li sherhi mendhumeti-l- adab*, Bejrut, Daru'l kutubu'l ilmije, 1996, v.1, f.211.

⁴³ Jusuf Kardavi, *Thekafetu ed-daije*, Muesesetu-rr-isale, botim i XI, Bejrut, 1987, f.32-33.

Rekomandime shkencore

Ky punim shkencor është përqendruar në një fushë dhe një metodologji të caktuar. Andaj në përfundim të këtij punimi jap këto rekomandime:

1. Ky parim mbetet obligim dhe përgjegjësi sociale, siç tregohet nga përsëritja e fjalës kuranore "grup" në ajetet e ndryshme dhe siç tregohet nga fjala "umet" e përmendur në shumë ajete kuranore. Kjo asocon edhe nga përmendja e mallkimit për ata që nuk ndalojnë të keqen ndërkohë që e kryejnë atë.
2. Nevoja për të studiuar edhe më shumë studimet dhe artikujt shkencorë që lidhen me këtë temë në dritën e zhvillimeve bashkëkohore dhe realiteteve e objektivave të shariatit nga këndvështrime të ndryshme. Kjo përfshin shqyrtimin e konteksteve të këtyre ajeteve, konteksteve në të cilat shfaqen, frazimin dhe gjuhën e përdorur, kuptimet e tyre dhe vendosjen e tyre përkrah ajeteve dhe haditheve e mendimeve të dijetarëve myslimanë me qëndrim mesatar. Të bëhen gjurmime mbi baza teologjike dhe juridike të urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja nga shkenca e fikhut.
3. **Përshtatja me realitetin postmodern ku analizohet aplikimi i parimit** urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja në shoqërinë moderne. Diskutoni sfidat dhe mundësitë e zbatimit të tij në kontekstin e sotëm gjeoislam e gjeoglobal.
4. Hulumtime kritike dhe krahasuese me nocione të ngjashme në fetë dhe në kontekste sekulare, duke diskutuar ngjashmëritë dhe dallimet në praktikën e tanishme.

Rezyme

Në fund të këtij punim shkencor arrijmë në përfundim se parimi i urdhërimit për të mirën dhe ndalimi nga e keqja në diskursin fetar përballen me disa sfida të rëndësishme dhe komplekse në shoqëritë myslimane veçanërisht si Kosova dhe vendet tjera evropiane që janë pakicë. Disa nga këto sfida përfshijnë: Ekziston sfidë dhe problem për aplikimin e konceptit të urdhërimit për të mirën dhe ndalimi nga e keqja e cila mund të interpretohet dhe kuptohet sipas nivelit kulturor dhe kjo përbën një sfidë në vete. Në hapësirat tona ka tentativa apo edhe ka rezistencë ndaj konceptit urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja nga ana e disa grupacioneve e organizatave joqeveritare e edhe individëve, që mund të kundërshtojnë përpjekjet për të vendosur standarde morale dhe shoqërore që i ka përbërje kultura islame, me pretekstin që është kulturë lindore dhe njeriu ka të drejtën dhe lirinë absolute të veprimit apo mos veprimit. Kjo bëhet edhe më e vështirë kur tanimë kemi shoqërinë që ka qasje në internet pandërprerë dhe lufta me përballjen me sfidat mes traditave zakoneve tradicionale islame me kontekstet dhe trendët globale gjë që përbën një sfidë shtesë për zbatimin urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja në mënyrë sa më efektive. Por ndihet nevoja e patjetërsueshme dhe duhet bërë përpjekje të

vazhdueshme që të promovohet sa më shumë ky parim islam në mesin e shoqërisë sonë dhe të jetë në top agjendë e da'ves-fetare ku caktohen edhe resurse tjera ndihmuese në këtë mision. Po ashtu një pikë me rëndësi që nxjerr nga ky studim është fakti se duhet angazhim dhe konsultim sa më i gjerë rreth formës së interpretimit, praktikimit dhe peshën e parimit të urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja në realitetin e pakicave islame dhe në përgjithësi shoqërive islame. Kjo mund të arrihet duke bërë ofrimin e lëndëve fetare të cilët i bëjnë përgatitjen e kuadrove për erën postmoderne që po e jetojmë ku do të promovohen vlerat e përbashkëta etike dhe realizimit të drejtësisë në shoqëri.

Referencat

- Al Araur, Adnan. *Menhexh ed-daveti fi devi- l- vakië el muasir*, botim i parë, Riad, pa vit botimi.
- Al-Otaibi, Aouidh Mahmoud. *El emru bi'l marufi ve 'nehji anil' munker fil'kuran*, Riad, 1436.
- Anderson, Chris. *Ted Talks*, përktheu nga anglishtja Valbona Nathanaïli, Pema, Tiranë, 2016.
- Athena du Pré, Ronald B. Adler, George Rodman. *Hyrje në komunikim*, Uetpress, Tiranë, 2023.
- Aydin, Hayati. *Kur'anda psikolojik Ikna*, Timas Yayinlan, Istanbul, 2001.
- Baudrillard, Jean. *La société de consommation*, përktheu Altin Qefalia, Logos-A, Shkup, 2020.
- Bayyah, Abdallah. *Tenbihi'l meraxhië ala te'ësili fikhi'l vakië*, botim i 4, Mesar lit'iba ven'neshr, Dubai, 2018.
- Buhariu, 6777. Hudud, 4.
- Buhariu, 6491. Rikak, 31.
- Büyükküpcü, Ramazan Tamer. *Ta jetosh jetën sipas Islamit*, përktheu Asllan Shehu, Alsar, Tiranë, pa vit botimi.
- Dağitmaç, Murat. *Neuropsikologu Şehadet ekmen*, përktheu shqip, Blerina Coka, Tiranë, 2020.
- Ebu Davud, 4477, Hudud, 35.
- Ed-dimeshki, Imam Hafidh e bil Fida Ismail ibn Kethir el Kureshi. *Tefsiru'l Kur'anil adhim*, Darul' marife, Bejrut, v.1, 1993.
- El Kahtani, Seid. *El hikmetu fid'daveti ilellahi teala*, Riad, botim i IV, 1424.
- El-Alvani, Taha Xhabir. *Reviving the balance. The authority of the Qur'an and the Status of the Sunnah*, shqipëroi Bujar H. Hoxha, Logos-A, Shkup, 2022.
- Essefarini, Muhamed. *Gidhau-l-bab li sherhi mendhumeti-l- adab*, Bejrut, Daru'l kutubu'l ilmije, 1996, v.1.
- Fuga, Artan. *Komunikimi në shoqërinë masive*, Papirus, Tiranë, 2014.
- Giddens, Anthony. *Sociologjia*, përktheu Teuta Starova Kastriot Myftiu, Çabej, Tiranë, 2004.
- Görmez, Mehmet. *Sünnet ve Hadisi Anlama Kilavuzu*, Otto, Akara, 2020.
- Hamidullah, Muhammed. *The emergence of islam- Lectures on the development of islamic eorld-vieë, intellectual tradition and polity*, Islamic Research Institute, 3rd reprint, Islamabad, 1999.
- <https://tanzil.net/#trans/sq.ahmeti/39:9> (data e qasjes më 12.04.2024).

- Islami nëpërmjet haditheve*, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Shkup, Logos-A, 2017, botim i II, v.3.
- Jekin, Fet'hi. *Kejfe ned'u ile'l islam*, Muesetu errisale, Bejrut, botim i III-të, 1977.
- Kamberi, Ferdi. *Dilemat e tranzicionit*, Artini, Prishtinë, 2019.
- Kardavi, Jusuf. *Edukimi kulturor i thirrësit*, përktheu Agim Abazi, Shoqata Bamirëse e Katarit me pëlqim të BIK-ut, Prishtinë, 2002.
- Kardavi, Jusuf. *Islami për tek i cili ftojme*, përktheu nga arabishtja, Rushit Musallari, Furkan ISM, Shkup, 2022.
- Kardavi, Jusuf. *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*, përktheu Flori Kola, Furkan ISM, Shkup, 2018.
- Kardavi, Jusuf. *Thekafetu ed-daije*, Muesesetu-rr-isale, botim i XI, Bejrut, 1987.
- Kayan, Ramazan. *Thirrja islame akt profetik*, Prizren, Fleta, 2017.
- Lucas, Stephen. *The art of public speaking*, Mc Graw-Hill, New York, 2007.
- Maigret, Eric. *Sociologjia e komunikimit dhe medievet*, përktheu nga frëngjishtja Blerta Hyska, Papirus, Tiranë, 2010.
- McGure Meredith. *Religjioni konketksti shoqëror*, përktheu nga anglishtja Ali Pajaziti, Logos.A, Shkup, 2007.
- Muslimi, 2594.
- Muslimi*, 3335, Iman, 204;
- Nabulsi, Muhamed Ratib. *Tefsiru en-Nabulsi: tedeberu ajati'l lahi fi en-nefsi ve el-keveni ve el-hajati*, vëll.4 botimi 1, Amman, 2017.
- Nasr, Sejjid Husejn. *El- Kur'an u kelimetull-llahi, masdaru el- ma'rifeti ve el-fi'ili*, i arabizuar nga Musa Safvan, revista "El-Mehaxhheh", daru el- Hadi, nr.10, Bejrut, 2004.
- Sardar, Ziauddin. *Fytyra të Islamit*, përktheu Mimoza Sinani dhe Elma Berisha, Logos-A, Shkup, 2017.
- Saricam, Ibrahim. *Hiz Muhammedi dhe mesazhi i tij universal*, Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, përktheu Florida Kulla, Ankara, 2018.
- Shami, Muhamed Mustafa. *Davabit ve adab el emru bil ma'rufi ve nehji anil munker*, <https://www.makkahacademy.org>. (01.09.2022).
- Talib, Hisham. *Besëlidhja e thirrjes islame*, Shkup, Logos-A, 2017.
- Talib, Hisham. *Etika e thirrjes islame drejt një ftese të moderuar në Islam*, përktheu Gentjan Fejzullaj, ISHMQI, botim i II-të, Tiranë, 2020.
- Ulvani, Taha Xhabir. *Min adab al-ihtilaf ila nabd al -ihtilaf* (muhtasar), The internacional Institute of Islamic Thought (IIIT), Herndon, USA.
- Winter, Tim. *Besimi, arsyeja, shpallja pikëtakimet e reja*, përktheu Arjol Guni dhe Rezart Beka, Erasmus, Tiranë, 2013.
- Zejdani, Abdulkërim. *Usulu'd-ave*, Muesesetu errisale, Bejrut, botimi i IX-të, 1999.